**L I G J**
**Nr.7975, datë 26.7.1995**

# PËR BARNAT NARKOTIKË DHE LËNDËT PSIKOTROPE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

## KREU I
## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë rregullat e prodhimit, fabrikimit, importimit, eksportimit, tregtimit, përdorimit, kontrollit dhe ruajtjes së barnave narkotike dhe lëndëve psikotrope.

### Neni 2

Në kuptim të këtij ligji, barna narkotike dhe lëndë psikotrope me prejardhje natyrore ose sintetike janë një grup i vecantë lëndësh, përdorimi abuziv i të cilave dëmton shëndetin dhe krijon varësi të përdoruesit nga këto lëndë.

## KREU II
## KLASIFIKIMI I BARNAVE NARKOTIKE DHE LËNDËVE PSIKOTROPE

### Neni 3

Lëndët dhe përgatesat e përfshira në këtë ligj janë klasifikuar në 3 tabela, I, II dhe III sipas masave të kontrollit që ushtrohen për këto lëndë.

### Neni 4

Të gjitha bimët dhe lëndët e klasifikuara si barna narkotike ose si lëndë psikotrope nga konventat ndërkombëtare ose akte të tjera në zbatim të këtyre konventave; përgatesat e tyre, si dhe gjithë bimët dhe lëndët e tjera të rrezikshme për shëndetin publik, për shkak të efekteve të dëmshme që rezultojnë nga keqpërdorimi i tyre, janë përfshirë në tri tabela. Klasifikimi i tyre është bërë në bazë të shkallës së rrezikshmërisë për shëndetin që mund të sjellë keqpërdorimi i tyre dhe faktit nëse ato kanë ose jo përdorim mjekësor.

Tabela I: bimë dhe lëndë me rrezikshmëri të lartë që nuk përdoren në mjekësi.

Tabela II: bimë dhe lëndë me rrezikshmëri të lartë që përdoren në mjekësi.

Tabela III: bimë dhe lëndë të rrezikshme që përdoren në mjekësi.

Tabelat II dhe III janë ndarë në dy grupe A dhe B sipas masave të kontrollit që zbatohen për to.

### Neni 5

Bimët janë shënuar me emrin e tyre shqip dhe latinisht, ndërsa lëndët janë shënuar me emrin ndërkombëtar në gjuhën shqipe ose në mungesë të tij, me emrin shkencor.

Neni 6

Përzierjet e ngurta ose tretësirat që përmbajnë një ose më shumë lëndë që kontrollohen nga ky ligj, si dhe lëndët psikotrope të dozuara, i nënshtrohen të njëjtit kontroll si dhe lëndët përbërëse të tyre. Përgatesat që përmbajnë dy ose më shumë lëndë, të cilat u nënshtrohen regjimeve të ndryshme kontrolli, do të trajtohen sipas regjimit të lëndës më të kontrolluar.

Neni 7

Tabelat janë përpiluar sipas Konventës Unike për Barnat Narkotikë të vitit 1961 dhe Konventës për Lëndët Psikotrope të vitit 1971.

Neni 8

Përgatesat, që përmbajnë një nga lëndët e tabelave II ose III, por që paraqet rrezik abuzimi të papërfillshëm, dhe kur lënda nuk mund të përftohet me metoda të thjeshta në sasi që krijojnë rrezik abuzimi, mund të përjashtohen nga disa masa kontrolli të parashikuara në këtë ligj me urdhër të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Në këtë urdhër përcaktohen qartë masat e kontrollit nga të cilat përjashtohen këto përgatesa.

KREU III
NDALIMI I KULTIVIMIT TË BIMËVE QË PËRMBAJNË LËNDË NARKOTIKE

Neni 9

Në Republikën e Shqipërisë ndalohet kultivimi i hashashit (Papaver somniferum) për prodhimin e opiumit dhe të kashtës; ndalohet kultivimi i bimës së kokës (Erythroxylon coca) për prodhimin e alkaloideve e të lëndëvee aromatike, si dhe kultivimi i bimës së kërpit indian (Cannabis sativa var. indica) për prodhimin e kanabisit dhe rrëshirës së kanabisit apo për qëllime industriale për prodhimin e fibrave dhe të farërave.

Neni 10

Pronari ose përdoruesi i tokës bujqësore e jobujqësore, si dhe të punësuarit pranë tyre, janë të detyruar të shkatërrojnë bimët e përmendura në nenin 9, kur ato rriten në mënyrë spontane në tokën e papunuar ose kanë qënë kultivuar në mënyrë të paligjshme nga paraardhësit e tyre.

KREU IV
NDALIMI I VEPRIMTARIVE QË LIDHEN MË LËNDËT DHE PËRGATESAT E TABELËS I

Neni 11

Ndalohet prodhimi, fabrikimi, tregtimi dhe shpërndarja me shumicë dhe pakicë, transportimi, mbajtja, furnizimi, dhënia me para ose falas, blerja, përdorimi, importimi, eksportimi, kalimi tranzit i bimëve, lëndëve dhë përgatesave të përfshira në tabelën I në territorin e Republikës së Shqipërisë.

KREU V
RREGULLIMI I VEPRIMTARIVE QË LIDHEN ME BIMËT,
LËNDET DHE PËRGATESAT E TABELAVE II DHE III

Neni 12

Lëndët e përfshira në tabelat II dhe III dhe përgatesat e tyre i nënshtrohen dispozitave të zbatueshme për të gjitha lëndët dhe përgatesat e destinuara për përdorim mjekësor e veterinar, siç përcaktohet në ligjin “Për barnat”, në masën që këto të fundit janë në pajtim me këtë ligj.

Neni 13

Prodhimi, fabrikimi, shitja me shumicë dhe më pakicë, tregtimi ndërkombëtar, përdorimi i bimëve, lëndëve dhe përgatesave te tabelave II dhe III u lejohet vetëm personave që janë të pajisur me licencë të posaçme për këto veprimtari. Për objektet dhe ndërtesat ku do të kryhen veprimtaritë e mësipërme kërkohet leje e posaçme.

A. LICENCA PËR KRYERJE VEPRIMTARIE.

Neni 14

Licenca për kryerjen e veprimtarive të parashikuara në nenin 13 miratohet nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit me propozim të Komisionit të Licencave Farmaceutike.

Licenca jepet ose refuzohet brenda 30 ditësh nga paraqitja e kërkesës.

Neni 15

Personat juridikë shtetërorë të caktuar posaçërisht nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit për të kryer veprimtaritë e përfshira në nenin 13 nuk kërkohet të pajisen me licencë.

I. KUSHTET E DHËNIES SË LICENCËS

Neni 16

Licenca mund të jepet vetëm në qoftë se përdorimi i lëndëve dhe përgatesave të tyre kufizohet për qëllime mjekësore dhe shkencore.

Përdorimi i lëndëve të tabelave II dhe III  në industri për qëllime të tjera mund të autorizohet vetëm në rastet kur kërkuesi tregon me prova se është në gjendje t'i sigurojë këto lëndë nga vjedhja, keqpërdorimi dhe ndryshimi i destinacionit, si dhe të sigurojë se produktet e fabrikuara nuk do të kenë efekte të dëmshme, nuk do të keqpërdoren dhe se lëndët nën kontroll që janë në përbërjen e tyre nuk mund të ripërftohen lehtësisht.

Dispozitat e këtij ligji, përveç atyre që lidhen me fabrikimin, nuk do të zbatohen për produktet që plotësojnë kushtet e përcaktura në paragrafin e dytë të ketij neni.

Neni 17

Të drejtën për t'u pajisur me licencë për ushtrim veprimtarie e kanë vetëm farmacistët ose personat juridikë nën drejtimin ose administrimin e të cilëve bën pjesë edhe një farmacist. Kur ndërmarrja ka më shumë se një degë, drejtimi teknik i secilës prej tyre duhet të kryhet të paktën nga një ndihmës farmacist. Në të gjitha rastet farmacisti është personalisht përgjegjës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe kushteve të parashikuara në licencë.

Neni 18

Dhënia e licencës kushtëzohet nga kualifikimi profesional i kërkuesit dhe plotësimi i kushteve të tjera të parashikuara në rregulloren përkatëse.

II. KËRKESA PËR LICENCË

1.TË DHËNAT QË JEPEN NË ÇDO KËRKESË

Neni 19

a) Në kërkesën për licencë që paraqitet nga një person fizik shënohet emri dhe adresa e tij, si

dhe shoqërohet me një vërtetim të shoqatës së farmacistëve ku është anëtarësuar.

b) Në kërkesën për licencë që paraqitet nga një person juridik shënohet emri (emërtimi) i personit juridik, emri dhe adresa e drejtuesit të tij, si dhe emri dhe adresa e personit përgjegjës për zbatimin e kushtevë të licencës shoqëruar me vërtetimin e shoqatës së farmacistëve ku bën pjesë.

Në të gjitha rastet në kërkesë shënohen emrat dhe adresat e të gjithë personave që do të marrin pjesë në kryerjen e veprimtarive, si dhe lloji i proceseve per të cilat kërkohet licenca.

## 2. TË DHËNA PLOTËSUESE QË DUHET TË JEPEN NË ÇDO KËRKESË SIPAS LLOJIT TË VEPRIMTARISË QË KËRKOHET TË KRYHET

### Neni 20

a) Kur kërkesa është formuluar për fabrikim, në të duhet të shënohen emërtimi dhe sasia e lëndëve të para që do të përdoren për fabrikim, lëndët dhe përgatesat që do të fabrikohen, procedurat e fabrikimit që do të përdoren, sasitë e lëndëve dhe përgatesave që parashikohen të fabrikohen së bashku me përbërjen dhe destinacionin e tyre.

b) Kur kërkesa është formuluar për përdorim të lëndëve në industri për qëllime të tjera jo mjekësore e shkencore, specifikohen procedurat e denatyrimit ose të tjera që do të përdoren për të siguruar që produktet e fabrikuara nuk mund të keqpërdoren ose të japin efekte të dëmshme, si dhe që lënda nën kontroll nuk mund të përftohet lehtësisht.

c) Kur kërkesa është formuluar për shitje me shumicë, në të shënohet emri i lëndëve dhe përgatesave që do të shiten.

ç) Kur kërkesa është formuluar për eksport dhe/ose import, në të shënohet natyra e veprimtarive të parashikuara, vendet me të cilat do të kryhen, si dhe emri i lëndëve dhe përgatesave objekt i këtyre veprimtarive.

## 3. PËRMBAJTJA DHE RËNDËSIA E LICENCËS

### Neni 21

Në licencë, përveç të dhënave të nenit 19, përcaktohet edhe afati i vlefshmërisë së saj. Në të tregohen lëndët dhe përgatesat që lidhen me veprimtarinë e autorizuar, sasitë e tyre, lloji i kontabilitetit që do të mbahet, si dhe gjithë kushtet e detyrimet e tjera që duhet të përmbushë mbajtësi i licencës.

### Neni 22

Licenca është vetjake dhe e patjetërsueshme.

Licenca mbulon të gjitha proceset që lidhen drejtpërdrejt me veprimtarinë e autorizuar.

### Neni 23

Çdo ndryshim i objektit, i emrit të personit juridik, i natyrës së veprimtarisë të tij, çdo ndryshim i bimëve, lëndëve dhe përgatesave të tabelave II dhe III që përfshihen në veprimtaritë e autorizuara, çdo ndryshim i proceduarave të fabrikimit, i natyrës ose përbërjes së lëndëve dhe përgatesave të fabrikuara bëhet vetëm me autorizim të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Ky autorizim jepet ose refuzohet brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

### Neni 24

Urdhri i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit për të ndaluar një ose më shumë procese që lidhen me bimët, lëndët ose përgatesat e tabelave II dhe III, e bën të pavlefshme licencën e mëparëshme lidhur me këto procese.

### Neni 25

Ndërmarrjet private të autorizuara dhe ndërmarrjet shtetërore të caktuara posaçërisht, kryejnë në territorin e Republikës së Shqipërisë blerjen, transferimin ose shpërndarjen e bimëve, lëndëve ose përgatesave të tabelave II dhe III vetëm me personat fizikë ose juridikë të autorizuar.

Neni 26

Ndërmarrja private e autorizuar mund t'i transferohet vetëm një personi fizik ose juridik të pajisur me licencë për të njëjtat veprimtari që kryhen me të njëjtat bimë, lëndë dhe përgatesa.

Në rast të vdekjes ose të pushimit të veprimtarisë së mbajtësit të licencës, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit mund të autorizojë, brenda 30 ditësh, vazhdimësinë e veprimtarisë nën përgjegjësinë e një zëvendësuesi që plotëson kushtet dhe që merr përsipër detyrimet e parashikuara në këtë ligj dhe në licencë.

4. PEZULLIMI DHE ANULIMI I LICENCËS

Neni 27

Licenca anullohet në rast se konstatohen shkelje të dispozitave të këtij ligji, parregullsi në ushtrimin e veprimtarisë së autorizuar, sidomos shkelje të detyrimeve të parashikuara në licencë, pakujdesi të personelit përgjegjës ose në rast se kërkesa për licencë përmban deklarime të pasakta.

Në rastet kur shkeljet e konstatuara nuk janë të rënda, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit mund të pezullojë licencën për një periudhë jo më të gjatë se 6 muaj.

Licenca mund t'i refuzohet ose/dhe t'i anullohet çdo personi që ka qënë i dënuar për trafik ose përdorim të paligjshëm të lëndëve dhe përgatesave objekt i këtij ligji. Licenca pezullohet deri në marrjen e vendimit të formës së prerë në rastet kur mbajtësi i licencës është në proces hetimi ose gjykimi për një nga këto shkelje.

Neni 28

Vendimi për refuzimin, pezullimin ose anullimin e licencës merret pasi pala e interesuar thirret për të dhënë shpjegime.

Vendimi për refuzimin, pezullimin ose anullimin e licencës duhet të jetë i motivuar dhe t'i njoftohet palës së interesuar. Vendimi i komunikohet organeve kompetente për të kontrolluar zbatimin e tij. Këto organe kanë listat e personave fizikë e juridikë të pajisur me licencë.

Neni 29

Vendimi i anullimit ose pezullimit të licencës merret pavarësisht nga sanksionet administrative e penale që mund të zbatohen.

Neni 30

Në rast se ndërmarrja e pushon veprimtarinë ose licenca anullohet apo i kalon afati, ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit i dorëzohen dokumentacioni i porosive dhe regjistrat. Në zbatim të vendimeve gjyqësore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit merr masat e nevojshme për sigurimin e materialeve që gjënden në to.

B. LEJA PËR PËRDORIMIN E OBJEKTEVE DHE NDËRTESAVE

Neni 31

Leja për të përdorur të gjithën ose një pjesë të objekteve dhe ndërtesave që disponon një

person juridik privat i autorizuar ose një ndërmarrje shtetërore e përcaktuar posaçërisht për prodhimin, fabrikimin, shitjen me shumicë, tregtinë ndërkombëtare dhe përdorimin e bimëve, lëndëve dhe përgatesave të tabelave II dhe III jepet nga ministri i Brendshëm.

Leja jepet ose refuzohet brenda 90 ditësh nga paraqitja e kërkesës.

Neni 32

Leja jepet vetëm për objekte dhe ndërtesa të përdorura nga persona fizikë e juridikë të pajisur me licencë siç përcaktohet në nenin 14, ose nga ndërmarrje shtetërore të caktuara posaçërisht për të kryer veprimtari me bimët, lëndët dhe përgatesat e tabelave II dhe III.

Neni 33

Në kërkesën për leje, saktësohet vendndodhja e çdo objekti e ndërtese që do të përdoret tërësisht apo pjesërisht, si dhe e drejta për shfrytëzimin e tyre. Kërkesa shoqërohet edhe me përshkrimin dhe planimetrinë e hollësishme të objektit apo ndërtesës.

Në kërkesë paraqiten masat e sigurimit që do të ndërmerren për të realizuar kontrollin dhe për të parandaluar vjedhjen dhe grabitjen e bimëve, lëndëve, përgatesave dhe produkteve të fabrikuara.

Në kërkesë shënohet emri dhe adresa e personit fizik a juridik që është ngarkuar posaçërisht me zbatimin e masave të sigurimt të parashikuara.

Neni 34

Lëshimi i lejes bëhet pasi verifikohet plotësimi i kushteve dhe masave të sigurimit të përcaktuara për objektet dhe ndërtesat në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtje së Mjedisit dhe ministrit të Brendshëm.

Neni 35

Çdo objekt dhe çdo ndërtesë duhet të pajisen me leje të veçantë. Megjithatë, i njëjti dokument mund të lejojë përdorimin e disa objekteve dhe ndërtesave.

Neni 36

Në leje përcaktohet afati i vlefshmërisë së saj. Në të cilësohen çdo objekt dhe çdo ndërtesë, ose pjesë të tyre, përdorimi i të cilave autorizohet.

Në leje precizohen masat e sigurimit që do të zbatohen në çdo rast, si dhe personi fizik a juridik që përgjigjet për zbatimin e tyre.

Neni 37

Krijimi i degëve, përdorimi i pjesëve të reja ose objekteve dhe ndërtesave të reja, si dhe çdo ndryshim në masat e sigurimit të specifikuara në leje, bëhet vetëm me autorizim paraprak të ministrit të Brendshëm.

Vendimi per lejimin ose refuzimin jepet brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

Neni 38

Leja mund të anullohet për gjithë objektet dhe ndërtesat, ose për disa prej tyre në rastet e mosrespektimit të detyrimeve të specifikuara në leje ose në rast se deklarimet e bëra në kërkesën për leje janë të pasakta.

Në rastet kur shkeljet e konstatuara nuk janë të rënda, Ministri i Brendshëm mund të pezullojë lejen për një periudhë jo më të gjatë se 6 muaj.

Neni 39

Vendimi për refuzimin, pezullimin ose anullimin e lejes merret pasi pala e interesuar thirret për të dhënë shpjegime.

Vendimi për refuzimin, pezullimin ose anullimin e lejes duhet të jetë i motivuar dhe t'i njoftohet palës së interesuar. Vendimi i komunikohet organeve kompetente për të kontrolluar zbatimin e tij. Këto organe kanë listat e ndërtesave dhe objekteve private e shtetërore të pajisur me leje.

Neni 40

Ndërpreja e vlefshmërisë së licencës, për arsye që lidhen me kryerjen e veprimtarive të autorizuara për të cilat përdoren objektet dhe ndërtesat, e bën të pavlefshme lejen e dhënë për këto të fundit.

## KREU VI
## PRODHIMI, FABRIKIMI, SHITJA OSE SHPËRNDARJA ME SHUMICË, TREGTIA NDËRKOMBËTARE DHE PËRDORIMI I LËNDËVE DHE PËRGATESAVE TË TABELAVE II DHE III

### A. KUFIZIMI I SASISË SË LËNDËVE

Neni 41

Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit cakton çdo vit sasitë maksimale të lëndëve dhe përgatesave të ndryshme që çdo person juridik privat dhe shtetëror mund të mbajë, duke pasur parasysh funksionimin normal të tyre dhe konjukturën e tregut. Këto kufizime mund të ndryshohen gjatë vitit nëse shihet e nevojshme.

### B. KUFIZIMI I FABRIKIMIT

Neni 42

Ministri i Shendetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit cakton çdo vit sasitë maksimale të lëndëve dhe përgatesave të ndryshme që çdo person juridik privat dhe shtetëror mund të fabrikojë duke pasur parasysh konjukturën e tregut. Këto kufizime mund të ndryshohen gjatë vitit nëse shihet e nevojshme.

### C. TREGTIA NDËRKOMBËTARE

Neni 43

Vetëm personat juridikë privatë të pajisur me licencë për kryerje veprimtarie sipas nenit 14 dhe ndërmarrjet shtetërore të caktuara posaçërisht, që përdorin objekte dhe ndërtesa të pajisura me leje sipas nenit 31, mund të kryejnë tregtinë ndërkombëtare të bimëve, lëndëve dhe përgatesave të tabelave II dhe III.

#### 1. EKSPORTI DHE IMPORTI

Neni 44

Eksportimi dhe importimi i bimëve, lëndëve dhe përgatesave të tabelave II dhe III bëhet vetëm me autorizim të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, sipas modelit të hartuar nga Komisioni i Barnave Narkotikë i Këshillit Ekonomik e Social të Kombeve të Bashkuara.

Ky autorizim është i patjetërsueshëm.

Neni 45

Në kërkesën për autorizim shënohet natyra e procesit që do të kryhet, emrat dhe adresat e importuesit/eksportuesit, emri i marrësit të ngarkesës në qoftë se njihet, emrin e përbashkët ndërkombëtar të çdo lënde dhe në rast se mungon një emërtim i tillë, emrin e lëndës në tabelat e konventave ndërkombëtare, forma farmaceutike dhe në qoftë se është fjala për një përgatesë, emrin e saj në qoftë se ekziston, sasia e çdo lënde dhe përgatesave, periudha kur do të kryhet eksporti/importi, menyra e transportit ose spedicionit, si dhe vendkalimi i kufirit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kërkesës për eksport i bëshkëlidhet autorizimi për import e lëshuar nga organet kompetente të vendit importues.

Neni 46

Autorizimi për import apo eksport përmban të njëjtat të dhëna, si dhe kërkesa për veprimtarinë që autorizohet. Autorizimi përcakton konkretisht nëse veprimi kryhet nëpërmjet një apo më shumë dërgesave.

Autorizimi për eksport përmban gjithashtu edhe numrin dhe datën e autorizimit të importit, i cili vërteton se importimi i lëndëve ose përgatesave është i autorizuar.

Neni 47

Një kopje autentike e autorizimit për eksport i bashkëlidhet çdo dërgese dhe ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit i adreson një kopje qeverisë së vendit ose territorit importues.

Neni 48

Në qoftë se sasia faktike e bimëve, lëndëve ose përgatesave të importuara është më e vogël se sasia e shënuar në autorizimin e eksportit, organet doganore dhe të kontrollit të barnave e shënojnë këtë fakt në dokument dhe në të gjitha kopjet zyrtare.

Neni 49

Kur dërgesa ka hyrë në tërritorin kombëtar ose kur periudha e caktuar në autorizimin për import mbaron, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit i dërgon qeverisë së vendit ose territorit eksportues autorizimin për eksport me të dhënat konkrete ku tregohet sasia e çdo bime, lëndë apo përgatesë të importuar në fakt.

Neni 50

Dokumentet tregtare të tilla si faturat, polic-ngarkesat, dokumentet e doganës, të transportit dhe spedicionit duhet të përmbajnë emrat e bimëve dhe të lëndëve sipas tabelave të konventave ndërkombëtare, emrat e përgatesave në rast se i kanë, sasitë e eksportuara ose që do të importohen, emrin dhe adresën e eksportuesit, importuesit dhe në, rast se njihet, edhe të marrësit të ngarkesës.

Neni 51

Eksportimet ose importimet në formën e dërgesave të adresuara për llogari të një personi me emër të ndryshëm nga ai që figuron në autorizimin përkatës janë të ndaluara.

Neni 52

Eksportimet në formën e një dërgese të adresuar një magazine të doganës janë të ndaluara, përveç rasteve kur qeveria e vendit importues miraton në certifikatën për import një dërgesë të tillë.

Importimet në formën e një dërgese të adresuar një magazinë të doganës janë të ndaluara,

përveç rasteve kur Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka miratuar në certifikatën e importit një dërgesë të tillë. Çdo tërheqje e mallit nga magazina bëhet me autorizim të autoriteteve prej të cilëve varet magazina. Çdo dërgesë me destinacion jashtë shtetit konsiderohet eksportim në kuptim të këtij ligji. Lëndët dhe përgatesat e depozituara në magazinën e doganës nuk duhet të pësojnë asnjë lloj trajtimi që do të ndryshonte natyrën e tyre. Ambalazhi i tyre nuk duhet të ndryshojë pa autorizim të autoriteteve prej nga varet magazina.

Neni 53

Dërgesat që hyjnë ose dalin pa qënë të shoqëruara me autorizimin përkatës për import apo eksport, bllokohen nga organet kompetente deri në vërtetimin e legjitimitetit të dërgesës ose daljen e vendimit për konfiskimin e saj.

Neni 54

Pikat doganore, ku lejohet kalimi i bimëve, lëndëve dhe përgatesave që importohen apo eksportohen, përcaktohen nga organet kompetente.

2. KALIMI TRANZIT

Neni 55

Ndalohet kalimi tranzit nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë i çdo dërgese të bimëve, lëndëve e përgatesave të tabelës II dhe III, pavarsisht nëse dërgesa është shkarkuar ose jo nga mjeti i saj i transportit. Bëjnë përjashtim rastet kur dërgesa shoqërohet me një kopje autentike të autorizimit për eksport, e cila u paraqitet organeve kompetente.

Neni 56

Ndalohet ndryshimi i drejtimit të kalimit tranzit të një dërgese në vendin tonë drejt një destinacioni të ndryshëm nga ai që figuron në kopjen e autorizimit për eksport që i bashkëngjitet dërgesës.

Ndryshimi i drejtimit të kalimit tranzit bëhet vetëm me autorizim të organeve përkatëse. Kërkesa për autorizimin e ndryshimit të drejtimit të tranzitimit të dërgesës trajtohet si të ishte një eksportim nga vendi ynë për në vendin e destinacionit të ri.

Neni 57

Asnjë dërgesë e lëndëve ose përgatesave që kalojnë tranzit në vendin tonë nuk mund të bëhet objekt i çfarëdo trajtimi që do të ndryshonte natyrën e tyre. Ambalazhi i i tyre nuk mund të ndryshojë pa lejen e organit të caktuar nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 58

Dispozitat e nenit 55, 56 dhe 57 nuk zbatohen në rastet kur dërgesa transportohet me avion, me kusht që avioni të mos ulet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në rast se avioni ulet, në varësi nga rrethanat, dërgesa do të trajtohet si eksportim nga vendi ynë drejt vendit të destinacinit dhe do t'i nënshtrohet dispozitave përkatëse.

3. PORTET DHE ZONAT E LIRA

Neni 59

Portet dhe zonat e lira i nënshtrohen të njëjtit kontroll dhe të njëjtës mbikqyrje si gjithë pjesët e tjera të territorit kombëtar.

## Ç. TRANSPORTI TREGTAR.

### Neni 60

Transportuesit tregtarë duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që mjetet e tyre të transportit nuk përdoren për trafikun e paligjshëm të barnave, lëndëve dhe përgatesave të përfshira në këtë ligj.

Personat fizikë e juridikë që merren me transport tregtar duhet :

- të paraqesin në kohën e duhur listën e mallrave që transportohen;
- të mbyllin mallrat në konteniere të vulosur me dyllë të kuq apo plumb, me vula të pafalsifikueshme dhe të dallueshme për kontrollin;
- të informojnë menjëherë organet kompetente për çdo rrethanë të dyshimtë për trafik të paligjshëm.

## D. DËRGESAT NË RRUGË POSTARE

### Neni 61

Dërgimi në rrugë postare i bimëve, lëndëve dhe përgatesave të përfshira në këtë ligj, lejohet vetëm në formën e pakove postare me vlerë të deklaruar dhe lajmërim- marrje.

# KREU VII
# TREGTIMI DHE SHPËRNDARJA ME PAKICË

## A. PËRDORIMI NË KLINIKË PËR NDIHMË URGJENTE DHE MJEKIMIN E TË SËMURËVE.

### Neni 62

Blerjet e bimëve, lëndëve dhe përgatesave të tabelës II dhe III për dhënien e ndihmës urgjente dhe mjekimin e të sëmurëve bëhet vetëm nga persona fizikë e juridikë privatë të pajisur me licencë sipas nenit 13 ose ndërmarrje shtetërore të caktuara posaçërisht sipas nenit 15 të këtij ligji.

### Neni 63

Vetëm personat fizikë e juridikë të mëposhtëm lejohen të marrin dhe mbajnë bimë, lëndë dhe përgatesa të tabelave II dhe III për nevoja të ndihmës urgjente profesionale :

- Farmacitë;
- Farmacitë e spitaleve shtetërore ose private dhe të qendrave shëndetësore;
- Depot shtetërore ose private të barnave që janë nën përgjegjësinë e farmacistit dhe të miratuara nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
- Spitalet dhe qendrat shëndetësore pa farmacist përgjegjës, por me një mjek që punon në institucion dhe mban përgjegjësinë për lëndët dhe përgatesat në fjalë;
- Mjekët dhe veterinerët e autorizuar të japin barna sipas një listë të përcaktuar përkatësisht nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit;
- Mjekët dhe veterinerët për nevoja të shërbimit të urgjencës brenda kufijve cilësore dhe sasiorë të përcaktuar përkatësisht nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit;
- Mjekët stomatologë dhe mamitë për nevoja të shërbimit të urgjencës sipas listës së përcaktuar nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

## B. SHITJA ME PAKICË TË SËMURËVE

## 1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR BIMËT, LËNDËT DHE PËRGATESAT E TABELAVE II DHE III.

Neni 64

Bimët, lëndët dhe përgatesat e tabelës II mund të përshkruhen dhe t'u jepen të sëmurëve në pajtim me përdorimin e tyre terapeutik dhe vetëm me recetë të lëshuar nga një kategori mjekësh, të cilët përcaktohen me udhëzim të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 65

Bimët, lëndët dhe përgatesat e tabelës III mund të përshkruhen dhe t'u jepen të sëmurëve në pajtim me përdorimin e tyre terapeutik dhe vetëm me recetë të lëshuar nga :

- Mjeku;
- Mjeku stomatolog për trajtimin e një sëmundjeje dentare;
- Mjeku veteriner për përdorim veterinar.

Neni 66

Barnat e tabelave II dhe III mund të shiten nga :

- Farmacitë dhe agjencitë farmaceutike;
- Farmacitë dhe agjencitë farmaceutike veterinare sipas listës së përcaktuar nga ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 67

Të gjitha recetat për këto barna duhet të përmbajnë :

- Emrin, specialitetin dhe adresën e mjekut përshkrues;
- Emrin e barit, dozën dhe instruksionet për përdorimin e tij;
- Sasinë e përshkruar ose periudhën e trajtimit dhe eventualisht numrin e recetave të përsëritura;
- Emrin, mbiemrin dhe moshën e të sëmurit; në recetën e lëshuar nga veterineri emrin dhe mbiemrin e pronarit të kafshës;
- Datën e lëshimit dhe firmën e vulën e mjekut përshkrues, dhe eventualisht vulën e institucionit.

Ndalohet ekzekutimi i recetave që nuk plotësojnë kërkesat e këtij neni.

Neni 68

Pas ekzekutimit të recetës, ajo vuloset nga farmacisti apo mjeku a veterineri i autorizuar të shesë barna, dhe i vendoset numri rendor i recetave të regjistruara (numri i kuponit) dhe data e dhënies së barit.

Neni 69

Kushtet dhe kriteret e përshkrimit dhe shitjes së barnave të tabelave II dhe III në spitale dhe qendra shëndetësore përcaktohen me urdhër të ministrit te Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 70

Pavarsisht nga dispozitat e nenieve 66, 67 dhe 68, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, nëse e kërkon situata dhe në kushtet që ai gjykon, mund të autorizojë në të gjithë vendin ose në një pjesë të tij, farmacistët e pajisur me licencë të shesin me pakicë, të furnizojnë lirisht dhe pa recetë të sëmurët, për qëllime vetëm mjekësore, sasi të vogla të lëndëve psikotrope të tabelës III dhe të përgatesave që i përmbajnë ato.

## 2. DISPOZITA TË VEÇANTA PËR BARNAT E TABELËS II

### Neni 71

Recetat për barnat e tabelës II do të përshkruhen pas vizitës së të sëmurëve në receta të posaçme për këtë qëllim, modeli i të cilave miratohet nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Në recetë shënohet edhe me fjalë doza dhe numri, si për specialitetet e gatshme, ashtu edhe për përgatesat magjistrale.

Mjekët do të ruajnë bllokun e kopje recetave për 3 vjet për t'ia paraqitur organeve kompetente, kur kërkohet prej tyre.

### Neni 72

Ndalohet përshkrimi dhe ekzekutimi i recetave që nuk plotësojnë kërkesat e nenit 71.

Ndalohet përshkrimi dhe ekzekutimi i nje recete që përshkruan barna të tabelës II për një periudhë më të gjatë se 7 ditë.

Ndalohet përshkrimi dhe ekzekutimi i një recete për barna të të njëjtës tabelë, të cilat i sëmuri është duke i përdorur sipas përshkrimit të një recete të mëparshme, përveçse kur mjeku përshkrues e përmend këtë në recetë dhe shpjegon gjendjen e përshkrimit të mëparshëm.

Ndalohen të sëmurët që kanë marrë një recetë për një ose më shumë barna të tabelës II, të marrin recetë të re për barna të të njëjtës tabelë gjatë periudhës së trajtimit të treguar në recetën e parë, pa njoftuar mjekun për recetat e mëparshme. Mjeku duhet të verifikojë në librin e shëndetit recetat e mëparëshme që ka përfituar i sëmuri.

### Neni 73

Pavarsisht nga dispozita e paragrafit të dytë të nenit 72, barnat e tabelës II me urdhër të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit mund të përshkruhen për një periudhë më të gjatë se 7 ditë, por jo për më shumë se 60 ditë. Këto barna përfshihen në grupin B të tabelës II.

### Neni 74

Në qoftë se prurësi i recetës nuk njihet personalisht nga personi i autorizuar të ekzekutojë recetën, ky i fundit mund të kërkojë të shohë letërnjoftimin.

Ndalohet ekzekutimi i recetave të lëshuara me shumë se 7 ditë përpara paraqitjes së tyre.

Farmacisti duhet t'i sistemojë recetat sipas rendit kronologjik dhe t'i ruajë ato për 3 vjet. Me kërkesën e klientit, farmacisti plotëson një kopje recete, ku shënohen dy vija diagonale dhe fjala "kopje".

### Neni 75

Personat e autorizuar që shesin barnat e tabelës II do t'i dërgojnë çdo tre mujor ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit një përmbledhje të recetave të ekzekutuara, duke shënuar për secilën emrin e mjekut përshkrues dhe llojin e sasinë e barnave të shitura.

## 3. DISPOZITA TË VECANTA PËR BARNAT E TABELËS III

### Neni 76

Shitja e një bari të grupit A të tabelës III mund të përsëritet vetëm me rekomandim me shkrim të mjekut përshkrues, ku saktësohen numri i përsëritjeve ose periudhën e trajtimit, dhe vetëm në mbarim të periudhës së përdorimit të barit të përcaktuar nga autori i recetës.

Shitja e barnave të grupit B të tabelës III mund të përsëritet vetëm në mbarim të periudhës së përdorimit të barit, në rast se nuk ka udhëzim tjetër nga autori i recetës.

## C. NDIHMA E PARË MEDIKAMENTOZE NË MJETET E TRANSPORTIT NDËRKOMBËTAR

### Neni 77

Ministri i Shëndetësisë mund të autorizojë mjetet e transportit publik të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, që qarkullojnë në linja ndërkombëtare, të mbajnë sasi të vogla të barnave të tabelës II dhe III në sasitë e nevojshme për dhënien e ndihmës së parë në rastet e urgjencës. Autorizimi i lëshuar me kërkesën e shfytëzuesit të mjetit të transportit përcakton masat e nevojshme për parandalimin e keqpërdorimit të barnave ose trafikimin e paligjshëm të tyre. Në të përcaktohen gjithashtu edhe kushtet e ruajtjes së barnave, regjistrimi i sasive të përdorura dhe të zëvendësuara periodikisht nga personi përgjegjës.

Përdorimi i këtyre barnave në rastet e urgjencës nuk konsiderohet shkelje e dispozitave të pikës B të këtij kreu.

## Ç. MBAJTJA E BARNAVE TË TABELAVE II DHE III NGA TË SËMURËT NË UDHËTIM

### Neni 78

Personat në mjekim, të cilët janë në udhëtim në territorin e Republikës së Shqipërisë, lejohen të mbajnë për përdorim personal barna që përmbajnë lëndë psikotrope të tabelës II dhe III në sasi që nuk i kalon 7 ditë mjekimi për barnat e tabelës II dhe 30 ditë mjekimi për barnat e tabelës III.

Këta të sëmurë duhet të kenë me vete kopje të recetave mjekësore përkatëse.

## D. PËRDORIMI I LËNDËVE PSIKOTROPE PËR KAPJE KAFSHËSH

### Neni 79

Me urdhër të vecantë të ministrit i Shëndetësisë dhë Mbrojtjes se Mjedisit dhe ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit përcaktohen lëndët psikotrope të tabelave II dhe III dhe përgatesat e tyre që mund të përdoren për kapje kafshësh, si dhe kushtet e përdorimit të tyre.

## DH. MBAJTJA E BARNAVE TË TABELËS II DHE III

### Neni 80

Ndalohet mbajtja për çdo qëllim e bimëve, lëndëve dhe përgatesave të tabelës II dhe III, përveç rasteve të parashikuara në këtë ligj.

# KREU VIII
# DISPOZITA TË VEÇANTA

## A. RAPORTIMI PERIODIK

### Neni 81

Personat fizikë e juridikë, privatë e shtetërorë, që kryejnë veprime që lidhen me bimët, lëndët dhe përgatesat e trajtuara në këtë ligj, i dërgojnë raporte periodike ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit :

1. Jo më vonë se 15 ditë pas mbarimit të çdo tremujori, për sasitë e çdo lënde e përgatese të importuar dhe eksportuar, duke treguar edhe vendin e origjinës dhe të destinacionit gjatë çdo tremujori.

2. Jo më vonë se 15 shkurti i çdo viti për të dhënat e vitit kalendarik paraardhës. Në raport saktësohen :

a. sasitë për çdo lëndë dhe përgatesë të prodhuar ose fabrikuar;

b. sasitë e çdo lënde të përdorur për fabrikim :

- lëndë dhe përgatesa që mbulohen nga ky ligj;
- lëndë dhe përgatesa që nuk mbulohen nga ky ligj.

c. sasitë e çdo lënde dhe përgatesë të konsumuar : të furnizuar për shpërndarje me pakicë, për përdorim mjekësor ose për kërkime shkencore.

ç. sasitë për çdo lëndë dhe përgatesë që janë gjendje më 31 dhjetor të vitit për të cilin raportohet.

Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit mund të kërkojë gjatë vitit raporte të veçanta.

## B. PLOTËSIMI I FLETË-POROSIVE PËR VEPRIMTARINË E PËRDITËSHME PROFESIONALE.

### 1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 82

Të gjitha porositë për bimët, lëndët dhe përgatesat e tabelës II paraqiten nga blërësi në dy fletë me numër rendor nga një bllok tip i miratuar nga ministri i Shëndëtesisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Fletët duhet të kenë të shënuar emrin, adresën dhe firmën e blerësit, emrin dhe sasinë e bimës, lëndës dhe përgatesës së porositur dhe datën e porosisë.

Shitësi do të mbajë një nga fletët e porosisë, ndërsa tjetrën ia dorëzon blerësit pas firmosjes dhe vulosjes së saj, duke shënuar njëkohësisht edhe numrin dhe datën e daljes në regjistrin e tij bashkë me sasinë e furnizuar.

Fletë-porosia për bimët, lëndët dhe përgatesat e tabelës III duhet të ketë vetëm emrat dhe sasitë e tyre.

Dokumentet ruhen nga palët e interesuara për 3 vjet, për t'ua paraqitur organeve kompetente sa herë që kërkohen prej tyre.

### 2. DISPOZITA TË VEÇANTA PËR POROSITË E BËRA NGA PERSONAT PËRGJEGJËS PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE PROFESIONALE

#### Neni 83

Porositë e bëra nga mjekët, stomatologët, veterinerët dhe mamitë për kryerjen e veprimtarisë së përditëshme profesionale do të plotësojnë kushtet e nenit 82.

Porositë e tyre duhet t'u drejtohen një farmacisti që ushtron veprimtarinë në zonën e tyre, dhe vetëm nëse nuk ka të tillë, do t'i drejtohen farmacistit në zonën më të afërt.

## C. REGJISTRIMI

### 1. REGJISTRIMI I VEPRIMEVE QË NUK LIDHEN ME SHITJEN TE TË SËMURËT

#### Neni 84

Të gjitha blerjet, transferimet, eksportet ose importet e bimëve, lëndëve dhe përgatesave të Tabelës II dhe III duhet të regjistrohen në kohën e kryerjes së veprimit në një regjistër të posaçëm me numër rendor dhe të sigluar nga organi i caktuar nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Regjistrimi bëhet pa fshirje dhe korrigjime dhe përmban : emrin dhe adresën e blerësit dhe shitësit, emërtimin, përbërjen dhe sasinë e çdo produkti të blerë, transferuar, importuar ose eksportuar, si dhe numrin e regjistrit të hyrjes apo daljes.

Personat juridikë që fabrikojnë, përpunojnë ose ndajnë, dhe përdorin këto lëndë për çfardo qëllimi, duhet të regjistrojnë në kohën e kryerjes së procesit, llojin dhe sasitë e çdo lënde të përdorur dhe çdo produkti të përftuar, si dhe të evidentojnë çdo humbje eventuale që rezulton gjatë proceseve të kryera.

Regjistri do të përdoret edhe për të evidentuar rrethanat në të cilat ndodh një humbje e shkaktuar nga zjarri, vjedhja ose çdo ngjarje tjetër. Në çdo rast për humbjet informohen menjëherë organet kompetente.

Regjistrimi bëhet në mënyrë të tillë që në çdo kohë të rezultojë saktë sasia e lëndëve që janë gjendje.

Regjistri ruhet për 10 vjet pas kryerjes së veprimit të fundit, për ta paraqitur kur kërkohet nga organet kompetente.

## 2. REGJISTRIMI I SHITJES PËR TË SËMURËT

### Neni 85

Personat e autorizuar që shesin barnat duhet të kryejnë regjistrimin sipas dispozitave të nenit 84 për çdo blerje dhe transferim të bimëve, lëndëve, përgatesave dhe barnave të tabelës II dhe III.

### Neni 86

Çdo shitje e barnave të tabelës II dhe III për të sëmurët do të regjistrohet nga personi i autorizuar për shitje menjëherë dhe pa fshirje e korrigjime në regjistrin e recetave.

Regjistri do të ketë një numër rendor të vecantë për çdo bar të shitur dhe do të përmbajë :

- emrin, specialitetin dhe adresën e autorit të recetës;
- emrin dhe adresën e të sëmurit, dhe për recetat e lëshuara nga mjeku veteriner, emrin dhe adresën e pronarit të kafshës;
- datën e lëshimit;
- emrin e barit ose formulën e përgatesës;
- sasinë e shitur.

Për barnat ose përgatesat e tabelës II, në regjistër do të shënohet edhe emri, adresa, numri i letërnjoftimit të personit që ka paraqitur recëtën, në rast se ky nuk është vetë i sëmuri dhe nuk njihet personalisht nga farmacisti.

Çdo përsëritje e recetës me barna të tabelave II dhe III kërkon një regjistrim të ri.

### Neni 87

Personat e autorizuar që shesin barna shënojnë në një regjistër të veçantë çdo humbje të shkaktuar nga zjarri, vjedhja ose çdo ngjarje tjetër, si dhe rrethanat në të cilat ndodh. Në çdo rast për humbjet informohen menjëherë organet kompetente.

### Neni 88

Regjistri i recetave dhe regjistri i veçantë ruhen për 10 vjet pas kryerjes së veprimit të fundit, për ta paraqitur kur kërkohet nga organet kompetente.

## Ç. KUSHTET E RUAJTJES

### Neni 89

Çdo person fizik a juridik, privat e shtetëror, që mban për qëllime të veprimtarisë së përditëshme profesionale bimë, lëndë, përgatesa ose barna të tabelës II duhet t’i ruajë ato në kushtet e përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe ministrit të Brendshëm, me qëllim që të parandalohet vjedhja ose çdo formë tjetër shperdorimi.

## D. INVENTARI DHE BILANCI

### Neni 90

Personat e përmendur në nenin 89 detyrohen që të paktën një herë në vit të bëjnë inventarin e bimëve, lëndëve, përgatesave ose barnave të tabelave II dhe III që disponojnë, si dhe bilancin e hyrjeve dhe daljeve.

Neni 91

Personat e pajisur me licencë për kryerje veprimtarie sipas dispozitave të këtij ligji, të cilët shesin ose tjetërsojnë veprimtarinë e tyre, janë të detyruar të bëjnë inventarin e bimëve, lëndëve, përgatesave ose barnave të tabelave II dhe III në prani të personit të cilit i kalojnë veprimtaritë, si dhe bilancin e hyrjeve dhe daljeve. Inventari dhe bilanci firmosen nga të dyja palët.

Neni 92

Çdo diferencë e konstatuar në bilanc ose midis bilancit dhe inventarit do t'i njoftohet menjëherë inspektorit të farmacive, i cili verifikon nëse diferenca është rezultat i vjedhjes, shpërdorimit apo ndonjë veprimi tjetër të paligjshëm.

DH. AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

Neni 93

Lëndët dhe përgatesat e tabelës II dhe III qarkullojnë të mbyllura në paketa ose ambalazh tjetër të përshtatshëm, me emërtimin të shënuar sipër, dhe në rastin e spedicioninimit të lëndëve të tabelës II, shënohet edhe një shirit i kuq i dyfishtë.

Ndalohet qarkullimi i lëndëve që nuk plotësojne kushtet e mësipërme të ambalazhimit.

Ambalazhimi i jashtëm i pakove që dërgohen nuk duhet të ketë sipër asnjë informacion tjetër përveç emrit dhe adresës së dërguesit dhe marrësit, si dhe vulën e dërguesit.

Neni 94

Etiketa me të cilën bari ofrohet për shitje do të ketë emrin e lëndëve të tabelës II dhe II që e përbëjnë, bashkë me përmbajtjen në njësi peshë ose përqindje.

Etiketat dhe fletë-shoqërueset e pakove për shitje me pakicë do të kenë indikimet e përdorimit, si dhe paralajmërimet e nevojshme për të mbrojtur përdoruesin.

Neni 95

Kërkesat e hollësishme për ambalazhimin dhe etiketimin e lëndëve të tabelës II dhe III përcaktohen në urdhrin e posaçëm të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

E. REKLAMA.

Neni 96

Ndalohet çdo reklamë e lëndëve, përgatesave dhe barnave të tabelës II dhe III që i drejtohet publikut të gjerë.

Ndalohet furnizimi i mjekëve me kampionë të lëndëve, përgatesave dhe barnave të tabelës II, si dhe shitja të sëmurëve e kampioneve të lëndëve, përgatesave dhe barnave të tabelës II dhe III.

Rregullorja për reklamën e këtyre lëndëve miratohet nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

KREU IX
KËRKIMET MJEKËSORE, SHKENCORE DHE MËSIMDHËNIA

Neni 97

Për nevoja të kërkimeve shkencore, mjekësore e të mësimdhënies, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit mund të autorizojë një person fizik të kultivojë, prodhojë, fabrikojë, blejë, importojë, përdorë dhe mbajë bimë, lëndë dhe përgatesa të tabelave I, II dhe III në sasitë minimale te domosdoshme për këto nevoja.

Personi i autorizuar shënon në një regjistër që ruhet për 10 vjet nga regjistrimi i fundit, sasitë e bimëve, lëndëve dhe përgatesave që kultivon, importon, blen, fabrikon, përdor dhe shkatërron. Në regjistër shënohen datat e operacioneve dhe emrat e furnizuesve. Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit i dërgohet një raport vjetor për operacionet e kryera dhe lëndët që janë gjendje.

## KREU X
## INSPEKTIMI DHE KONSTATIMI I SHKELJEVE

Neni 98

Të gjithë personat fizikë e juridikë, privatë e shtetërorë, të cilët merren me veprimtari që lidhet me bimët, lëndët, përgatesat dhe barnat që përfshin ky ligj, do të kontrollohen e mbikqyren nga organet e autorizuara nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe ministri i Brendshëm.

Inspektorët e farmacisë, si dhe organet e tjera të autorizuara, do të bëjnë të paktën një herë në dy vjet inspektimin e zakonshëm të objekteve, ndërtesave, lëndëve gjendje dhe regjistrave. Inspektimet e jashtëzakonshme kryhen në çdo kohë.

Ky kontroll shtrihet edhe në mjediset ku ndodhen pajisjet e ndihmës së parë në mjetet e transportit publik të linjave ndërkombëtare.

Neni 99

Inspektorët e farmacisë lejohet të hyjnë, të marrin kampione dhe të bllokojnë veprimtaritë ose lëndët, në çdo rast kur konstatohen shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi. Kontrolli në ndërtesat private, vecanërisht kur u përkasin personave pa licencë, në rastin kur dyshohet për kryerjen e veprimtarive të paligjshme, bëhet vetëm me marrëveshje me shkrim të këtyre personave ose në përputhje me dispozitat në fuqi.

Inspektorët e farmacisë duhet të bëjnë kallëzim në organet kompetente të hetimit kur konstatojnë shkelje të dispozitave të këtij ligji që përbëjnë vepër penale.

Neni 100

Personat fizikë dhe juridikë që kryejnë veprimtari të parashikuara në këtë ligj duhet të bashkëpunojnë me organet e kontrollit dhe t’u krijojnë lehtësitë e nevojshme për kryerjen e inspektimeve dhe të kontrollit të dokumentacionit.

## KREU XI
## KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 101

Kur shkelja e dispozitave të parashikuara në neniet 13-18, 22-26, 30-38, 41-44, 47, 50-52, 55-57, 61-68, 71-72, 74-94, 96-99 të këtij ligji nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 10.000 deri 100.000 lekë. Në rast përsëritjeje gjoba është nga 20.000 deri 200.000.

Pengimi i inspektorëve të farmacive në kryerjen e detyrës dënohet me gjobë deri 50 000 lekë.

Neni 102

Ankimi kundër vendimeve të organit administrativ dhe ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas ligjit nr. 7697, datë 7.4.1993 “Për kundravajtjet administrative”.

## KREU XII
## DISPOZITA TË FUNDIT

### Neni 103

Skema e klasifikimit dhe tabelat e barnave narkotike, lëndëve psikotrope dhe përgatesave të tyre janë pjesë përbërëse e këtij ligji.

### Neni 104

Të gjitha dispozitat që bijen në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

### Neni 105

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.1184, datë 8.8.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha**

## SKEMA E KLASIFIKIMIT TË BARNAVE NARKOTIKE DHE LËNDËVE PSIKOTROPE

<table>
<tr><td colspan="3">BARNA NARKOTIKE DHE LËNDË PSIKOTROPE</td></tr>
<tr><td colspan="2">Lëndë shumë të rrezikshme</td><td>Lëndë të rrezikshme</td></tr>
<tr><td>Tabela I</td><td>Tabela II</td><td>Tabela III</td></tr>
<tr><td>Lëndë që nuk përdoren në mjekësi</td><td colspan="2">Lëndë që përdoren në mjekësi</td></tr>
<tr><td>(1)Barna narkotike të listës IV të Konventës për Narkotikët, 1961 dhe lëndët psikotrope të Listës I të Konventës për Lëndët Psikotrope, 1971.<br>(2) Eventualisht lëndë të Listave të tjera të Konventave të lartpërmendura<br>(3) Eventualisht lëndë të tjera</td><td>(1)Barna narkotikë të Listës I[1] dhe II të Konventës për Narkotikët, 1961.<br>(2)Lëndë psikotrope të Listës II të Konventës për Lëndët Psikotrope,1971<br>(3)Eventualisht lëndë të listave të tjera të Konventave të lartpërmendura, me përjashtim të lëndëve që përfshihen në tabelën I (shih majtas)<br>(4)Eventualisht lëndë të tjera<br><br>Grupi A: Lëndë dhe barna që mund të përshkruhen për jo më shumë se 7 ditë.<br>Grupi B: Lëndë dhe barna që mund të përshkruhen për jo më shumë se 60 ditë</td><td>(1)Përgatesat e Listës III të Konventës për Narkotikët, 1961.<br>(2)Lëndët psikotrope të Listës III dhe IV të Konventës për Lëndët Psikotrope, 1971.<br>(3) Eventualisht lëndë të tjera<br><br>Grupi A: Lëndë dhe barna për të cilat ndalohet ripërsëritja e recetës pa autorizim me shkrim të përshkruesit të recetës.<br><br>Grupi B: Lëndë dhe barna për të cilat lejohet ripërsëritja e recetës, me përjashtim të rastit kur përshkruesi i recetës mendon ndryshe.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Kontroll i rreptë i trafikut të paligjshëm</td><td>Kontroll i trafikut të paligjshëm</td></tr>
<tr><td colspan="3">Ndiqet penalisht mbajtja për konsum vetjak</td></tr>
</table>

1) Me përjashtim të lëndëve të Listës IV.

TABELA I
LISTA IV (KONVENTA E 1961)

Acetil - alfa - metilfentanil (**)
Acetorfinë
Alfa - metifentanil
Alfa - metiltiofentanil
Beta - hidroksifentanil
Beta - hidroksi - 3 metilfentanil
Dezomorfinë
Etorfinë
Heroinë
Kanabis, rrëshirë e kanapisit, ekstrakte dhe tinktura të kanabisit
Ketobemidon
3 - metilfentanil
3 - metiltiofentanil
MPPP
Para - fluorofentanil
PEPAP
Tiofentanil

LISTA I (KONVENTA E 1971)

Brolamfetaminë
DET
DMA
DMHP
DMT
DOET
Eticiklidinë
Katinon
(+) - Lizergid
MDMA
Meskalinë
4 - metil - aminoreks
MMDA
N - etil - tenamfetaminë
N - hidroksi - tenamfetaminë
Parheksil
PMA
Psilocinë, psilotsinë
Psilocibinë
Roliciklidinë
STP, DOM
Tenamfetaminë
Tenociklidinë
Tetrahidrokanabinol
TMA

TABELA II
LISTA I (KONVENTA E 1961)

Acetilmetadol

Alfacetilmetadol
Alfameprodinë
Alfametadol
Alfaprodinë
Alfentanil
Alilprodinë
Anileridinë
Benzetidinë
Benzilmorfinë
Betacetilmetadol
Betameprodinë
Betametadol
Betaprodinë
Bezitramid
Butirat i dioksafetilit
Dekstromoramid
Diampromid
Dietiltiambuten
Difenoksilat
Difenoksinë
Dihidromorfinë
Dimenoksadol
Dimepheptanol
Dimetiltaiambuten
Dipipanon
Drotebanol
Ekgoninë, esteret dhe derivatet e saj
Etilmetiltiambuten
Etokseridinë
Etonitazen
Fenodokson
Fenampromid
Fenazocinë
Fenamorfan
Fenoperidinë
Fentanil
Furetidinë
Gjethe e kokës
Hidrokodon
Hidroksipetidinë
Hidromorfinol
Hidromorfon
Izometadon
Klonitazen
Kodoksimë
Kokainë
Koncentrat i kashtës së hashashit
Levofenacilmorfan
Levometorfan
Lavomoramid
Lavorfanol
Metadon
Metazocinë
Metildezorfinë
Metildihidromorfinë

Metobromid i morfinës dhe derivate të tjerë të morfinës të azotit 5 valentë
Metopon
Mirofinë
Morferidinë
Morfinë***
Morfinë - N - oksid
Nikomorfinë
Noracimetadol
Norlevorfanol
Normetadon
Normorfinë
Norpipanon
Oksikodon
Oksimorfon
Opium
Petidinë
Produkt ndërmjetës A i petidinës (4-cian-1-metil-4-fenilpiperdinë)
Produkt ndërmjetës B i petidinës (esteri etilik i acidit 4-fenilpiperidinë-4-karboksilik).
Produkt ndërmjetës C i petidinës (acid 1-metil-4-fenilpiperidinë-4-karboksilik)
Produkt ndërmjetës i metadonit (4-cian-2-dimetilamino-4,4-difenilbutan)
Produkt ndërmjetës i moramidit (acid 2-metil-3-morfolino-1,1-difenilpropan karboksilik)
Piminodinë
Piritramid
Proheptazinë
Properidinë
Racemetorfan
Racemoramid
Racemorfan
Sufentanil
Tebainë
Tebakon
Tilidinë
Trimeperdinë

## LISTA II (KONVENTA E 1961)

Acetildihidrokodeinë
Dekstropropoksifen
Dihidrokodeinë
Etilmorfinë
Folkodinë
Kodeinë
Nikodikodinë
Nikokodinë
Norkodeinë
Propiram.

## LISTA II (KONVENTA E 1971)

Amfetaminë
Deksafetaminë
Dronabinol
Fenciklidinë
Fenetilinë

Fenmetrazinë
Levamfetaminë
Levometamfetaminë
meklokualon
Metakualon
Metamfetaminë
Metilfenidat
Racemat i metamfetaminës
Sekobarbital

TABELA III
LISTA III (KONVENTA E 1961)

1. Përgatesat e acetildihidrokodeinës, dihidrokodeinës, etilmorfinës, folkodinës, kodeinës, nikodikodinës, nikokodinës dhe norkodeinës kur kombinohen me një ose më shumë ingredientë të tjerë dhe që përmbajnë jo më shumë se 100 mg të barit narkotik për dozë, si dhe përgatesat e padozuara me një përqendrim jo më shumë se 2.5 për qind.

2. Përgatesat e propiramit që përmbajnë jo më shumë se 100 mg propiram për dozë dhe të kombinuara të paktën me të njëjtën sasi metilceluloze.

3. Përgatesat e dekstropropoksifenit për përdorim nga goja që përmbajnë jo më shumë se 135 mg dekstropropoksifen bazë për dozë ose përgatesat e padozuara me një përqendrim jo më shumë se 2.5 për qind me kusht që këto përgatesa të mos përmbajnë ndonjë lëndë që janë në kontroll sipas Konventës për lëndët psikotrope e 1971.

4. Përgatesat e kokainës që përmbajnë jo më shumë se 0.1 për qind kokainë e llogaritur si kokainë bazë dhe prëgatesat e opiumit ose të morfinës që përmbajnë jo më shumë se 0.2 për qind morfinë e llogaritur si morfinë bazë pa ujë, si dhe të kombinuara me një ose më shumë ingredientë të tjerë në një mënyrë të tillë që bari narkotik nuk mund të rimerret lehtësisht dhe në sasi që të rrezikojë shëndetin e popullatës.

5. Përgatesat e difenoksinës që përmbajnë jo më shumë se 0,5 mg difenoksinë për dozë dhe një sasi sulfat atropinë të paktën 5 për qind të dozës së difenoksinës.

6. Përgatesat e difenoksilatit që përmbajnë jo më shumë se 25 mg difenoksilat për dozë, llogaritur si bazë dhe një sasi sulfat atropinë të paktën 1 për qind të dozës së difenoksilatit.

7. Pulvis ipecacuanhae et opii compositus:
Pluhur opiumi 10 për qind
Pluhur i rrënjës së ipekës 10 për qind
Pluhur plotësues që nuk përmban ndonjë bar narkotik 80 për qind.

8. Përgatesat e lartpërmendura të kombinuara me prëgatesa të tjera që nuk përmbajnë barna narkotikë.

LISTA III (KONVENTA E 1971)

Amobarbital
Buprenorfinë
Butalbital
Ciklobarbital
Glutetimid
Katinë
Pentazocinë
Pentobarbital

LISTA IV (KONVENTA E 1971)

Alobarbital
Alprazolam
Amfepramon

Barbital
Benzfetaminë
Bromazepam
Butobarbital
Delorazepam
Diazepam
Estazolam
Etilamfetaminë
Etil loflazepat
Etinamat
Etklorvinol
Fendimetrazinë
Fenkamfaminë
Fenobarbital
Fenproporeks
Fenterminë
Fludiazepam
Flunitrazepam
Flurazepam
Halazepam
Haloksazolam
Kamazepam
Ketazolam
Klobazam
Kloksazolam
Klonazepam
Klorazepat
Klordiazepoksid
Klotiazepam
Lefetaminë
Loprazol
Lorazepam
Lormetazepam
Mazindol
Medazepam
Mefenoreks
Meprobamat
Metilfenobarbital
Metiprilon
Midazolam
Nimetazepam
Nitrazepam
Nordazepam
Oksazepam
Oksazolam
Pemolinë
Pinazepam
Pipradrol
Prazepam
Pirovalerion
Sekbutabarbital
Temazepam
Tetrazepam
Triazolam
Vinilbital

*) Renditja alfabetike e barnave narkotikë dhe lëndëve psikotrope në tre tabela dhe tetë lista është bërë në pajtim me nenet 3,4 të këtij ligji sipas Konventës për Barnat Narkotike të vitit 1961 dhe Konventës për Lëndët Psikotrope të vitit 1971 të rishikuara dhe që janë në fuqi që prej 1 korriku 1993.

**) Lëndët shënohen me emra të përbashkët ndërkombëtar ose me emrat që përdoren në konventat ndërkombëtare në fuqi, në gjuhën shqipe.

***) Këtij ligji i nënshtrohen edhe izomerët, esteret, eteret, kriprat dhe prëgatesat e lëndëve që përfshihen në të gjitha listat e mësipërme veç rasteve kur ato përjashtohen nga masat e kontrollit.